

**Gen-I Tirana Sh.p.k**  
**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare të Konsoliduara**  
**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

**PËRMBAJTJA:**

<b>Pasqyrat financiare të konsoliduara:</b>	<b>Faqe</b>
<b>Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>4</b>
<b>Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>5</b>
<b>Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6</b>
<b>Pasqyra e konsoliduar e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>7</b>
<b>Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara</b>	<b>8-23</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtuesve të Shoqërisë Gen I Tirana Sh.p.k.

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Gen I Tirana Sh.p.k (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e konsoliduar të performancës financiare, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital neto dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”-të).

#### Baza për opinionin

Kemi përfunduar auditimin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standard janë të përshkruara në seksionin e “Përgjegjësisë të Audituesit” të këtij raporti, për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Jemi të pavarur nga Shoqëria sipas kërkesave të Kodit të Etikës e miratuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Ekspertët Kontabël dhe sipas kërkesave etike për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi plotësuar përgjegjësitë tona etike sipas këtyre kërkesave. Besojmë se evidencat e auditimit të marra gjatë procesit të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë këtë opinion.

#### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese, si dhe nëse transaksionet dhe ngjarjet në pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

**Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

*Deloitte Audit Albania sh.p.k*

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,

Tirana, Albania

Identification number (NUIS): L41709002H

**DELOITTE AUDIT ALBANIA**

Ad: Rr. Elbasanit, Pll. nr 1, kt 2, poshte Fakultetit Gjeologji Miniera

Tel: 044517920

**NIPT: L 41709002 H TIRANA - ALBANIA**

Enida Cara  
Auditues ligjor




Tiranë, Shqipëri  
30 mars 2018

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

<u>Aktivët</u>	Shënim	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
<b>I. Aktivët afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	28,371,342	236,011,584
Llogari të arkëtueshme	5	2,270,392,016	321,807,078
Tatim Fitim i arketueshëm	6	27,961,916	63,921,897
TVSH e arketueshme	6	433,897,081	497,020,386
Taksa Bashkiake te arketueshme	6	51,500	
Shpenzime te shtyra	6	19,914,239	21,168,808
<b>Total i aktiveve afatshkurtra (I)</b>		<b>2,780,588,094</b>	<b>1,139,929,753</b>
<b>II. Aktivët afatgjata</b>			
Licencë	7	-	-
Paisje informatike	7	12,407	16,543
Mobilje zyre	7	222,357	277,946
Aktive të tjera afatgjata	7	27,531	34,414
<b>Totali i aktiveve afatgjata (II)</b>		<b>262,295</b>	<b>328,903</b>
<b>Totali i aktiveve (I + II)</b>		<b>2,780,850,389</b>	<b>1,140,258,656</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>I. Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	8	2,346,727,919	1,054,932,602
Të pagueshme ndaj personelit	9	18,943,850	18,871,671
Të pagueshme ndaj shtetit	10	410,988	330,681
Të pagueshme te tjera		634,554	496,353
Hua nga Gen-I d.o.o	11	210,050,363	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>		<b>2,576,767,674</b>	<b>1,074,631,307</b>
<b>II. Detyrimet afatgjata</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve (I + II)</b>		<b>2,576,767,674</b>	<b>1,074,631,307</b>
<b>III. Kapitali</b>			
Kapitali shoqërisë	12	6,050,000	6,050,000
Rezerva rivleresimi	12	14,181	20,564
Fitimi i mbartur	12	8,200,000	8,200,000
Fitimi i periudhës	12	189,818,534	51,356,785
<b>Totali i kapitalit (III)</b>		<b>204,082,715</b>	<b>65,627,349</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)</b>		<b>2,780,850,389</b>	<b>1,140,258,657</b>

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 u aprovuan më 30 Mars 2018 dhe u nënshkruan si më poshtë:

  
Z. Igor Koprivnikar  
Përfaqësues Ligjor

**gen-i** 03

GEN-I Tirana Sh.p.k.  
Ish-Noll Business Center  
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Tirana, Albania  
Unique Identification no. K814150054

**GEN-I Tirana Sh.p.k**  
**Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
*(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<b>Të ardhurat nga aktiviteti</b>		
Të ardhurat nga shitja e energjisë	13 7,595,715,331	2,727,338,943
Të ardhura të tjera	13 -	3,833,892
	<b>7,595,715,331</b>	<b>2,731,172,835</b>
<b>Shpenzimet operative</b>		
Materiale të konsumuara	14 (7,337,957,066)	(2,645,672,607)
Shpenzime personeli		
Pagat e personelit	15 (10,712,335)	(9,775,394)
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	15 (777,672)	(713,550)
Amortizimi i aktiveve afatgjata	16 (66,608)	(152,409)
(Shpenzime) Rimarrje e provizionimeve	16	(4,907)
Shpenzime të tjera	17 (24,441,927)	(18,792,183)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>	<b>(7,373,955,608)</b>	<b>(2,675,111,050)</b>
<b>Fitimi nga veprimtaria operative</b>	<b>221,759,723</b>	<b>56,061,785</b>
Të ardhura/ (shpenzime) nga interesi	18 (414,408)	(234,029)
Të ardhura/ (shpenzime) nga kursi i kembimit	2,042,195	4,678,880
<b>Fitimi i periudhës</b>	<b>1,627,787</b>	<b>4,444,851</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>223,387,510</b>	<b>60,506,636</b>
Tatimi mbi fitimin	19 (33,568,976)	(9,149,851)
<b>Fitimi i vitit</b>	<b>189,818,534</b>	<b>51,356,785</b>

Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

*Z. Igor Koprivnikar*  
Përfaqësues Ligjor

**gen-i** 03

GEN-I Tirana Sh.p.k.  
B:1-Null Business Center  
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Tirana, Albania  
Unique identification no.: K81413005A

**GEN-I Tirana Sh.p.k**  
**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
*(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

	<b>Kapitali</b>	<b>Rezerva nga konvertimi i monedhave te huaja</b>	<b>Rezerva te tjera</b>	<b>Fitime te akumuluar</b>	<b>Totali</b>
<b>Me 31 Dhjetor 2015</b>	<b>6,050,000</b>	<b>11,414</b>	<b>-</b>	<b>171,322,349</b>	<b>177,383,763</b>
Efekte e ndryshimit te kurseve te kembimit gjate konsolidimit	-	9,150	-	-	9,150
Dividend i paguar	-	-	-	(163,122,349)	(163,122,349)
Fitimi neto i periudhes	-	-	-	51,356,785	51,356,785
<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>	<b>6,050,000</b>	<b>20,564</b>	<b>-</b>	<b>59,556,785</b>	<b>65,627,349</b>
Rezerva te tjera	-	-	-	-	-
Efekte e ndryshimit te kurseve te kembimit gjate konsolidimit	-	(6,383)	-	-	(6,383)
Dividend i paguar	-	-	-	(51,356,785)	(51,356,785)
Fitimi neto i periudhes	-	-	-	189,818,534	189,818,534
<b>Me 31 Dhjetor 2017</b>	<b>6,050,000</b>	<b>14,181</b>	<b>-</b>	<b>198,018,534</b>	<b>204,082,715</b>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8–23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.



**GEN-I Tirana Sh.p.k**
**Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**
*(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)*

Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor, 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor, 2016
<b>I. Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtarita operative</b>		
Fitimi i vitit	19	189,818,534
Rregullime per:		51,356,785
Amortizimi dhe zhvleresimi	7	66,608
Provigjione	16	-
Shpenzime per interesa	18	414,408
(Fitimi) / Humbje te parealizuara nga kursi kembimit	18	(6,387)
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin punues</b>	<b>190,293,163</b>	<b>51,961,554</b>
<i>Levizje ne kapitalin punues:</i>		
Renie ne llogarite e arketueshme	(1,948,584,938)	1,882,197,637
Renie ne llogarite e arketueshme te tjera	100,286,354	(137,743,949)
Rritje/ (renie) ne llogarite e pagueshme	1,291,795,317	(1,196,719,594)
Rritje/ (renie) ne detyrime te tjera	290,691	(46,909)
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtarite operative</b>		
Interesi i paguar	(414,408)	(443,211)
Tatim fitimi i paguar	-	-
<b>Fluksi i mjeteve monetare e (perdorur) / gjeneruar ne veprimtarine operative</b>	<b>(366,333,821)</b>	<b>599,205,528</b>
<b>II. Rrjedhja e parase nga veprimtarite e investimit</b>		
Shitja e aktiveve afatgjata	-	-
Blerja e aktiveve afatgjata	-	-
<b>Fluksi i mjete monetare te perdorur ne veprimtarine e investimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>III. Fluksi i mjete monetare nga veprimtarite e financimit</b>		
Ripagim i huase	210,050,364	(204,547,200)
Divident te paguar	(51,356,785)	(163,122,349)
<b>Fluksi i mjete monetare te perdorur ne veprimtarine financuese</b>	<b>158,693,579</b>	<b>(367,669,549)</b>
<b>IV. Renie neto e mjeteve monetare</b>	<b>(207,640,242)</b>	<b>231,535,979</b>
<b>V. Mjetet monetare ne fillim te vitit</b>	<b>236,011,584</b>	<b>4,475,605</b>
<b>VI. Mjetet monetare ne fund te vitit</b>	<b>28,371,342</b>	<b>236,011,584</b>

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

GEN- I Tirana Sh.p.k (në vijim referuar si “Shoqëria”) është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më 13 shkurt 2008 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër identifikimi K81413005A. Ortaku i vetëm i Shoqërisë është GEN-I d.o.o (shoqëria mëmë). Zyrat kryesore të Shoqërisë janë në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali” nr.27. Shoqëria ka hapur një degën të re në Kosovë në dhjetor 2010.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shitja me shumicë e energjisë elektrike. Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Igor Koprivnikar.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 3 (31 dhjetor 2016: 3 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **2.1 Baza e përpuethshmërisë**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit Shqiptar (SKK).

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Në këto pasqyra të konsoliduara financiare janë përgatitur në Lekë shqiptar (LEK), e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

### **2.4 Parimi i Vijimësisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjëndje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet e saj një periudhë, të paktën dymbëdhjetë muaj mbas datës së raportimit.

### **2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave të konsoliduara financiare kërkon nga Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat e konsoliduara financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave të konsoliduara financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra të konsoliduara financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

## **3. Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat që paraqiten në këto pasqyra të konsoliduara financiare.

*(Të gjitha shumatat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)*

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhim)**

#### **3.1 Transaksione në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejte rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi këmbimi me datë 31 dhjetor 2017 është 132.95 Lekë/Euro (2016: 135.23 Lekë/Euro).

#### **3.2 Instrumenta financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbehen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqëria mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Degës skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë paranë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra. Për qëllimin e pasqyrës së konsoliduar të rrjedhës së parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara e parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhena*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

*(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)*

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhim)**

#### **3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)**

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

*(I) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur perfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(II) Kostot e mëparshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin

*(III) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe llogaritet mbi jetën e dobishme të çdo pjese të aktivitetit duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

#### **3.4 Zhvlerësimi**

*(I) Aktive financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normen efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rendësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

**3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhim)**

**3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)**

*(I) Aktive financiare (vazhdim)*

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(II) Aktive jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.5 Provigjonet**

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

**3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

**3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**3.8 Tatimi mbi fitim**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve dhe është bazuar në shumën e tatim fitimit të pagueshëm mbi bazën e fitimit të tatueshem sic përcaktohet në rregullat përkatëse statimore të kontabilitetit.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrat financiare të konsoliduara, sepse permban zëra të të ardhurave apo shpenzimeve të cilat janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera, si edhe përjashton, zëra të cilat nuk konsiderohen asnjëherë të tatueshëm apo të zbritshëm.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Shuma e tatimit të shtyrë e dhënë është bazuar në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e bilancit.

*(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)*

### **3.9 Konsolidimi**

Pasqyrat e konsoliduara financiare duhet të ndjekin procedurat e mëposhtme për konsolidim:

- kombinimin e aktiveve, detyrimeve, kapitalit, të ardhurave, shpenzimeve dhe rrjedhës së parasë të shoqërisë mëmë me ato të filialeve.
- eliminojë shumën e investimit të shoqërisë mëmë tek filialet dhe porcionin e kapitalit tek secili filial.
- eliminojë plotësisht aktivet dhe detyrimet, kapitalin, të ardhurat, shpenzimet dhe rrjedhën e parasë brënda grupit lidhur me transaksionet midis entiteteve të grupit (fitime dhe humbje rezultuar nga transaksione brënda grupit të cilat janë të njohura në aktive si psh inventarët dhe aktivet fikse, janë plotësisht të eliminuara)

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***4. Mjete monetare**

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
<b>Banka</b>		
Lek	6,753,663	1,271,249
Valute e huaj	21,617,679	234,740,335
<b>Totali</b>	<b>28,371,342</b>	<b>236,011,584</b>

**5. Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Me palët e treta	2,105,016,293	322,598,692
Me palët e lidhura	225,708,743	59,541,406
Zhvierësimi i llogarive të arkëtueshme	(60,333,020)	(60,333,020)
<b>Totali</b>	<b>2,270,392,016</b>	<b>321,807,078</b>

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e treta konsistojnë në të drejta ndaj klientëve në lidhje me shitjen e energjisë.

Shtesa e zhvierësimit për llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
<b>Teprica në fillim të vitit</b>	60,333,020	60,328,113
Provizionimi për shpenzime interesi	-	102,640
Rimarrje provizion	-	(97,733)
<b>Teprica në fund të vitit</b>	<b>60,333,020</b>	<b>60,333,020</b>

**6. Llogari të tjera të arkëtueshme**

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
TVSH e arketueshme	433,897,081	497,020,386
Tatim Fitim i arketueshem	27,961,916	63,921,897
Taksa Bashkiake te arketueshme	51,500	-
Shpenzime te shtyra	19,914,239	21,168,808
<b>Totali</b>	<b>481,824,736</b>	<b>582,111,091</b>

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***6.1 Llogari të tjera të arkëtueshme (vazhdim)**

Tatim fitimi i arkëtueshëm përbëhet si më poshtë:

	<b>Më</b>	<b>Më</b>
	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Gjendja e tatim fitimit ne fillim periudhes	63,921,897	81,283,585
Tatim fitimi 2015	(967)	-
Tatim fitimi 2016	(1,029)	-
Rimarrje nga akt kontrolli		(8,211,837)
Kompensim me detyrim Tatim ne Burim	(2,389,009)	-
Detyrimi per tatim fitimin	(33,568,976)	(9,149,851)
<b>Tatim fitim i arketueshem</b>	<b>27,961,916</b>	<b>63,921,897</b>



**7. Aktive afatgjata materiale**

Llogaritë e aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	Licence	Mjete dhe Pajisje	Mobilje zyre	Aktive te tjera materiale	Totali
<b>Kosto</b>					
<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>	<b>688,050</b>	<b>116,815</b>	<b>729,147</b>	<b>93,352</b>	<b>1,627,364</b>
Shtesa					
<b>Me 31 Dhjetor 2017</b>	<b>688,050</b>	<b>116,815</b>	<b>729,147</b>	<b>93,352</b>	<b>1,627,364</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>					
<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>	<b>(688,050)</b>	<b>(100,271)</b>	<b>(451,202)</b>	<b>(58,938)</b>	<b>(1,298,461)</b>
Shtesa	-	(4,136)	(55,589)	(6,883)	(66,608)
<b>Me 31 Dhjetor 2017</b>	<b>(688,050)</b>	<b>(104,407)</b>	<b>(506,791)</b>	<b>(65,821)</b>	<b>(1,365,069)</b>
<b>Vlera neto</b>					
<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>	-	<b>16,544</b>	<b>277,945</b>	<b>34,414</b>	<b>328,903</b>
<b>Me 31 Dhjetor 2017</b>	-	<b>12,408</b>	<b>222,356</b>	<b>27,531</b>	<b>262,295</b>

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***8. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura	1,919,517,845	1,031,112,327
Te pagueshme ndaj paleve te treta	426,879,916	23,550,986
Fatura te pamberritura	330,158	269,289
<b>Totali</b>	<b><u>2,346,727,919</u></b>	<b><u>1,054,932,602</u></b>

**9. Të pagueshme ndaj personelit**

Të pagueshme ndaj personelit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Te pagueshme ndaj personelit	18,943,850	18,871,671
<b>Totali</b>	<b><u>18,943,850</u></b>	<b><u>18,871,671</u></b>

**10. Të pagueshme ndaj shtetit**

Të pagueshme ndaj shtetit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është përbërë si më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Tatim mbi te ardhurat personale	250,470	185,742
Sigurime Shoqerore dhe Shendetesore	110,016	99,386
Tatimi ne burim	49,963	45,553
Te tjera	539	-
<b>Totali</b>	<b><u>410,988</u></b>	<b><u>330,681</u></b>

**11. Humarrje**

Huaja e marrë nga Shoqëria Gen-I D.o.o më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet nga sa më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Huamarrje nga Gen-I D.o.o	210,050,363	-
<b>Totali</b>	<b><u>210,050,363</u></b>	<b><u>-</u></b>

Sipas Marrëveshjes së nënshkruar midis Shoqërisë dhe Shoqërisë Gen-I D.o.o nr. 3/2016, huaja është një formë financimi që kjo e fundit jep për Shoqërinë në mënyrë që kjo e fundit të përmbushë detyrimet afatashkurtra të saj gjatë aktivitetit operativ me palë të treta.

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***12. Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë i regjistruar është 6,050,000 Lek i ndarë në 1kuote me vlerë nominale prej 6,050,000 Lek (2016: 6,050,000 Lek i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale prej 60.500 Lek)

Shoqëria ka shpërndarë dividendë gjatë 2017 me vlerë 51.4 milion Lek. Rezerva nga rivleresimi është krijuar nga konvertimi i llogarive të ardhurave dhe shpenzimeve nga Euro në Lek të degës në Kosovë.

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Kapitali shoqërisë	6,050,000	6,050,000
Rezerva rivleresimi	14,181	20,564
Fitimi i akumuluar	8,200,000	8,200,000
Fitimi i periudhës	189,818,534	51,356,785
<b>Totali</b>	<b>204,082,715</b>	<b>65,627,349</b>

**13. Të ardhura nga shitja e energjisë**

Të ardhurat nga shitja e energjisë gjatë vitit 2017 dhe 2016 rezultojnë si më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Shitje energjie brenda vendit	6,764,459,964	1,676,386,363
Shitje energjie jashte vendit	546,230,363	996,728,985
Tarifë Sherbimi	285,025,004	54,223,595
<b>Totali</b>	<b>7,595,715,331</b>	<b>2,727,338,943</b>

**14. Materiale të konsumuara**

Shpenzimet për blerje energjie gjatë vitit 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Blerje energjie	6,490,916,444	2,236,278,988
Blerje kapacitete	847,040,622	409,393,619
<b>Totali</b>	<b>7,337,957,066</b>	<b>2,645,672,607</b>

**15. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit gjatë vitit 2017 dhe 2016 janë përbërë si më poshtë:

	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më</b> <b>31 Dhjetor 2016</b>
Shpenzime personeli		
Paga	10,712,335	9,775,394
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	777,672	713,550
<b>Totali</b>	<b>11,490,007</b>	<b>10,488,944</b>

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***16. Provigjone**

Shpenzimet e provigjionimeve janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Shtesë provigjioni për llogari të arkëtueshme	-	102,640
Rimarrje provizion	-	(97,733)
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>4,907</b>

**17. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet e tjera janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Sherbim menaxhimi	12,931,648	5,781,055
Sherbim ligjor	2,238,848	4,910,084
Sherbim konsulence	1,925,749	3,010,653
Infrastruktura	1,361,791	-
Qira	1,272,146	1,514,272
Shpenzime për shërbimet bankare	1,158,532	679,035
Sherbim perkthimi	834,800	177,000
Shpenzime auditi	665,344	611,838
Tatime të tjera	596,516	270,690
Shpenzime interneti	326,291	295,982
Sherbim agjensie doganore	280,637	232,500
Shpenzim telefoni	263,029	278,580
Akomodimi	185,046	-
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	160,398	32,347
Udhetime	158,247	64,462
Sherbim noterie	31,000	13,000
Blerje kancelari	27,667	12,083
Gjoha dhe dëmshpërblime	13,083	10,000
Shpenzime te tjera	11,155	898,602
<b>Totali</b>	<b>24,441,927</b>	<b>18,792,183</b>

Shërbimet e menaxhimit përfaqësojnë shpenzime të realizuara nga GEN-I d.o.o për të suportuar aktivitetin e Shoqërisë bazuar në Marrëveshjen e Shërbimeve të Administrimit. Keto shpenzime përcaktohen mbi bazën e nivelit të shitjeve të Shoqërisë në vitin aktual. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2017 vjen nga rritja e shitjeve sipas shënimit 13

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***18. Të ardhura financiare neto**

Të ardhurat / shpenzime financiare – neto janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi	8	29
Shpenzime interesi	(414,416)	(234,058)
<b>Totali</b>	<b>(414,408)</b>	<b>(234,029)</b>

	Më 31 Dhjetor 2017	Më 31 Dhjetor 2016
Fitime te perealizuara nga shkembimet valutore	29,205,158	14,202,992
Fitime te realizuara nga shkembimet valutore	1,074,029	6,128,557
<b>Nëntotali</b>	<b>30,279,187</b>	<b>20,331,549</b>
Humbje te perealizuara nga shkembimet valutore	(25,680,252)	(13,989,568)
Humbje te realizuara nga shkembimet valutore	(2,556,740)	(1,663,101)
<b>Nëntotali</b>	<b>(28,236,992)</b>	<b>(15,652,669)</b>
<b>Totali</b>	<b>2,042,195</b>	<b>4,678,880</b>

**19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri, norma e tatim fitimit është 15% për 2017 (2016: 15%). Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që vlerësohen nga autoritetet tatimore. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është i përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Fitimi përpara tatimit</b>	<b>223,793,171</b>	<b>60,937,400</b>
<b>Shpenzimet e pazbritshme</b>	<b>90,592</b>	<b>61,610</b>
Shpenzime provigjionimi		4,907
Penalitete, gjoba	13,083	10,000
Shpenzime të tjera të pazbritshme	77,509	46,703
Humbje të degës Kosovë		
<b>Totali i shpenzimeve te pazbritshme</b>	<b>90,592</b>	<b>61,610</b>
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>223,883,763</b>	<b>60,999,010</b>
<b>Shpenzimi i tatim fitimit 15%</b>	<b>33,582,564</b>	<b>9,149,852</b>

**20. Palët e lidhura**

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është fuqia për të drejtuar politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të marrë përfitime nga veprimtaritë e saj. Kontrolli supozohet të ekzistojë, kur prindi, zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të filialit.

Përmbledhja e transaksioneve me palët e lidhura është si më poshtë:

	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017</b>	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016</b>
<b>Aktive</b>		
Te arketueshme nga Gen-I doo	225,708,743	59,541,406
<b>Detyrime</b>		
Te pagueshme ndaj Gen-I doo	1,919,517,845	1,031,112,327
Hua nga Gen-I d.o.o	210,050,363	-
<b>Te ardhura</b>		
Shitje ndaj Gen-I doo	248,253,267	1,020,620,906
Shitje ndaj Gen-I Beograd		
<b>Shpenzime</b>		
Blerje mallra nga Gen-I Athens		9,052,911
Blerje mallra dhe shpenzime menaxhimi nga Gen-I D.o.o	6,133,591,891	1,650,959,879

**21. Manaxhimi i rrezikut financiar**

**a) Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normave të interesit përbën rrezikun e luhatjeve të vlerave të instrumentave financiarë si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave, në lidhje me aktivet ndryshojnë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar Shoqëria. Aktivet dhe pasivet e Shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

**b) Rreziku i kredisë**

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, ndaj nuk ka ndikim në pozitën dhe performancën e saj financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***21. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****c) Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare janë të kufizuara vetëm në llogaritë e pagueshme në rrjedhën normale të biznesit dhe të pagueshme ndaj furnitoreve. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2017 është paraqitur më poshtë:

<b>Me 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Deri ne 3 muaj</b>	<b>3 deri ne 12 muaj</b>	<b>1 deri ne 5 vjet</b>
<i>Aktive financiare</i>				
Mjete monetare	28,371,342	28,371,342	-	-
Llogari te arketueshme	2,270,392,016	2,270,392,016	-	-
Llogari te tjera te arketueshme	481,824,736	4,509,486	51,500	477,263,750
<b>Totali</b>	<b>2,780,588,094</b>	<b>2,303,272,844</b>	<b>51,500</b>	<b>477,263,750</b>
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari te pagueshme	2,346,727,919	2,183,656,953	163,070,966	-
Llogari te tjera te pagueshme	230,039,755	212,129,288	-	17,910,467
<b>Totali</b>	<b>2,576,767,674</b>	<b>2,395,786,241</b>	<b>163,070,966</b>	<b>17,910,467</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>203,820,420</b>	<b>(92,513,397)</b>	<b>(163,019,466)</b>	<b>459,353,283</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2016 është paraqitur më poshtë:

<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Vlera mbartur</b>	<b>Deri në 3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vjet</b>
<i>Aktive financiare</i>				
Mjete monetare	236,011,584	236,011,584	-	-
Llogari të arkëtueshme	321,807,078	321,807,078	-	-
Llogari të tjera të arkëtueshme	582,111,091	146,481,782	208,177,184	227,452,125
<b>Totali</b>	<b>1,139,929,753</b>	<b>704,300,444</b>	<b>208,177,184</b>	<b>227,452,125</b>
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	1,054,932,602	390,628,739	664,303,863	-
Llogari të tjera të pagueshme	19,698,705	679,967	-	19,018,738
<b>Totali</b>	<b>1,074,631,307</b>	<b>391,308,706</b>	<b>664,303,863</b>	<b>19,018,738</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>65,298,446</b>	<b>312,991,738</b>	<b>(456,126,679)</b>	<b>208,433,387</b>

**GEN-I Tirana Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***21, Menxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****d) Rreziku nga kursi i këmbimit**

Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është paraqitur më poshtë:

<b>Me 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Eur</b>	<b>Lek</b>
Mjete monetare	<b>28,371,342</b>	21,617,679	6,753,663
Llogari te arketueshme	<b>2,270,392,016</b>	2,264,880,546	5,511,470
Llogari te pagueshme	<b>2,346,727,919</b>	2,340,587,346	6,140,573
Hua nga Gen-I d.o.o	<b>210,050,363</b>	210,050,363	-
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(258,014,924)</b>	<b>(264,139,484)</b>	<b>6,124,560</b>

<b>Me 31 Dhjetor 2016</b>	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Eur</b>	<b>Lek</b>
Mjete monetare	<b>236,011,584</b>	234,740,335	1,271,249
Llogari te arketueshme	<b>321,807,078</b>	321,807,078	-
Llogari te pagueshme	<b>1,054,932,602</b>	1,031,550,472	23,382,130
Hua nga Gen-I d.o.o	-	-	-
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(497,113,940)</b>	<b>(475,003,059)</b>	<b>(22,110,881)</b>

Gjatë vitit u aplikuan kurset e mëposhtme të këmbimit:

<b>LEK</b>	<b>Kursi mesatar 2017</b>	<b>Kursi mesatar 2016</b>	<b>Kursi i këmbimit në datat raportuese</b>	
			<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>EUR</b>	134.12	137.35	132.95	135.23

*Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit*

Analiza e ndjeshmërisë e paraqitur më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit në valutë të huaj në datën e raportimit dhe ndryshimeve të përcaktuara të ndodhura në fillim të vitit financiar dhe duke mbajtur konstant gjatë periudhës raportuese, Më poshtë është një paraqitje e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi fitimin neto, duke konsideruar të gjitha variablat e tjera konstante:

	<b>Më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Më 31 Dhjetor 2016</b>
Euro zhvleresohet me 10 %	26,413,948	47,500,305
Euro rivleresohet me 10 %	(26,413,948)	(47,500,305)



## **22. Angazhime dhe pasiguri**

### ***Ceshtje ligjore***

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria është përfshirë në disa padi dhe konflikte gjyqësore. Drejtimi mendon se këto çështje nuk do kenë efekt material në pozicionin financiar apo rezultatin operativ të Shoqërisë.

### ***Ceshtja me OSHEE***

Shoqëria është në proces gjyqësor me OSHEE, për dëmet ndaj buxhetit të shtetit që supozohet se ka ndodhur për shkak se kompanitë GEN-I, GEN-I Tiranë, GEN-I doo Athinë nuk i kanë respektuar rregullat e konkurrencës gjatë pjesëmarrjes në tenderat e vitit 2014 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2015 për mbulimin e humbjeve. Shuma e parashikuar e humbjes që pretendohet nga OSHEE është 59,877,160 Lek. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi në vitin 2017 se nuk ka autoritet mbi shqyrtimin e veprimeve juridike, duke argumentuar se palët kanë rënë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktuale nëpërmjet arbitrazhit. Paditësi tashmë ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Shkalles së Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Drejtimi i Shoqërisë beson se rezultati do të jetë ende në favorin e Shoqërisë. Nëse OSHEE do të dërgojë çështjen në Arbitrazh në Zvicër Drejtimi dhe Shoqëria do të ketë ende arsye të mira për të fituar për një rast që nuk ka një shkak të vërtetë veprimi. Drejtimi i Shoqërisë vlerëson se bashku me opinionin e eksperteve të pavarur ligjore të brendshëm dhe të jashtëm se nuk ekziston asnjë rrezik që kërkesa e OSHEE ndaj GEN-I Tirana të jetë e suksesshme dhe se do të lëshohet një gjykim negativ për GEN-I Tiranë. Rrjedhimisht, Drejtimi i Shoqërisë nuk ka provigjionuar asnjë vlerë në këto pasqyra financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017.

### ***Angazhime kapitale apo operacionale***

Më 31 dhjetor 2017, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale të kontraktuara por ende të papaguara,

## **23. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra të konsoliduara financiare,